



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Zyra e Kryeministrit –Ured Premijera –Office of the Prime Minister

Agjencia e Statistikave të Kosovës - Agencija za Statistiku Kosova - Kosovo Agency of Statistics

Duke u bazuar ne Ligjin Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civilë te Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2010 Procedurat e Rekrutimit ne Shërbimin Civil te Republikës se Kosovës , *Agjencia e Statistikave të Kosovës* shpallë:

KONKURS

1. Departamenti i Regjistrimit dhe Anketimit , dy (2) pozita te karrierës:

Titulli: Një (1) Zyrtar ne zyrën rajonale te statistikës ne Mitrovicë

Numri i referencës : ASK-DRA-001

Koeficienti : 7

Detyrat dhe përgjegjësit :

- 1 . Kryen anketat për të gjitha hulumtimet në nivel të rajonit të Mitrovicës
- 2 . Kryen grumbullimin, monitorimin dhe kontrollimin e çmimeve artikujve të konsumit të gjerë
- 3.Kryen grumbullimin, monitorimin dhe kontrollimin e çmimeve të artikujve bujqësor,
- 4 . Kryen grumbullimin, monitorimin dhe kontrollimin e çmimeve të pemëve dhe perimeve në tregun e gjelbër,
- 5.Kryen plotësimin, monitorimin dhe kontrollimin e Raporteve tremujore të çmimeve të Importit,
- 6.Zhvillon raporte të mira me responentët, bënë kontrollimin dhe analizën logjike të hulumtimeve statistikore,
- 7.Kujdeset për shpërndarjen, distribuimin dhe grumbullimin e raporteve në teren ,
8. Me kërkesën e shefit të Zyrës rajonale, përcjell dhe monitoron personat e angazhuar në teren gjatë procesit te implementimit te projekteve të planifikuara nga ASK-ja,
- 9 . Raporton te Udhëheqësit te zyrës rajonale për dinamikën e aktiviteteve sipas agjendës që ka parashtruar Departamenti i ASK-ës.

Kualifikimi : Diploma universitare –Fakulteti nga fushat ekonomike, shoqërore, juridike, apo te ngjashme.

Përvoja e punës: kandidati duhet te ketë 2 vite përvojë pune.

Kompetenca dhe aftësitë:

-Njohja e kompjuterit (Word ,Excel,Outlook) ,

-Bashkëpunimi ne mënyrë ekipore e nevojshme,

-Të ketë aftësi të ruajtjes së konfidencialitetit të të dhënave individuale statistikore.

-Shkathësi ne realizimin e punëve dhe detyrave sipas planit vjetor te zyrës rajonale

-Shkathësi të mira të komunikimit , përfshirë aftësinë për të interpretuar informata , dhënë udhëzime dhe përcjellë informata tek të tjerët;

Titulli: Një (1) Zyrtar ne zyrën rajonale te statistikës ne Prishtinë

Numri i referencës : ASK-DRA-002

Koeficienti : 6

Detyrat dhe përgjegjësit :

1 Sigurimin e formularëve, kontrollimi dhe plotësimi i formularëve te respodenteve,

2.Shpërndarja e formularëve dhe pranimin e tyre,

3.Angazhimi ne përcjelljen e çmimeve te produkteve te konsumit te gjerë ,

4.Grumbullon , kontrollon dhe azhuron te dhënat e buxhetit familjar ne regjionin e Prishtinës dhe te njëjtat ju përcjellë shërbimeve gjegjëse ne ASK-se.,

5. Është i angazhuar ne anketën e fuqisë punëtore,

6.Angazhimi ne regjistrimin e qarqeve statistikore ,

7. Angazhimi ne anketën e biznesit te ndërmarrjeve, bujqësisë,

8. Per punen e vet i pergjigjet eprorit te vet.

Kualifikimi : Diploma universitare –Fakulteti nga fushat ekonomike, shoqërore, juridike, apo te ngjashme.

Përvoja e punës: kandidati duhet te ketë 2 vite përvojë pune.

Kompetenca dhe aftësitë:

-Njohja e kompjuterit (Word ,Excel,Outlook) ,

-Bashkëpunimi ne mënyrë ekipore e nevojshme,

-Të ketë aftësi të ruajtjes së konfidencialitetit të të dhënave individuale statistikore.

-Shkathësi ne realizimin e punëve dhe detyrave sipas planit vjetor te zyrës rajonale

-Shkathësi të mira të komunikimit , përfshirë aftësinë për të interpretuar informata , dhënë udhëzime dhe përcjellë informata tek të tjerët;

Procedura e konkurimit:

Në Shërbimin Civilë kanë të drejtë të punësohen shtetasit e Republikës se Kosovës të moshës madhore ,të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, përgatitje të nevojshme arsimore dhe aftësi profesionale për zbatimin funksionit administrativ dhe të cilët kanë aftësi fizike që kërkohen për pozitën përkatëse.

Aktet ligjore dhe nënligjore qe e rregullojnë rekrutimin:

Përzgjedhja e Shërbyesve Civilë bëhet në pajtim me Ligjin –Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civilë te Republikës se Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e rekrutimit ne Shërbimin Civilë.

Kohëzgjatja e emërimit: Sipas Ligjit të Shërbimit Civil të Republikës së Kosovës , në të cilën është përfshirë periudha e punës provuese prej një (1) viti.

Afati i konkurrimit është prej datës : 09/10/ 2017 deri me datë 23 /10/2017, deri në orën 16:00

Marrja dhe dorëzimi i aplikacioneve:

Aplikacionet merren dhe dorëzohen në Agjencionin e Statistikave të Kosovës , Rr, "Zenel Salihu" nr.4 Prishtinë. Aplikacionit i bashkëngjiten kopjet e dokumentacionit mbi kualifikimin, dëshmi mbi përvojën e punës , vertetimin nga Gjykata që personi nuk është nën hetime dhe dokumentacionet e tjera të nevojshme , që kërkohen për vendin e punës për të cilin konkurren. Kërkesat e derguara pas datës së fundit nuk do të pranohen. Kërkesat e pakompletuara do të refuzohen.

Për shkak të numrit të madh të kërkesave të pranuar , vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen.

Kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të nënshtrohen testimit me shkrim dhe intervistimit.

Për informata të hollësishme, mund të kontaktoni me zyrën e personelit , në tel: 038- 20031149 , prej orës 08:00 – 16: 00.

“Shërbimi Civilë i Kosovës ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë.

“Komuniteti jo - shumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në organet e shërbimit civil të administratës publike qendrore dhe lokale, siç specifikohet në Nenin 11, paragrafin 3 të Ligjit Nr. 03/L-149 mbi Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës”.